

**DEKLARATA E ZAHIR TANIN, PËRFAQËSUESIT SPECIAL TË
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM DHE SHEFIT TË UNMIK-UT NË
DEBATIN E KËSHILLIT TË SIGURIMIT PËR UNMIK-UN**

Nju Jork

16 gusht 2017

Z. President, shkëlqesi,

Ky tremujor është përshkuar me mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme të përgjithshme në Kosovë dhe me negociatat e gjata pasuese, me arritjen e marrëveshjeve dhe me pazare për themelimin e qeverisë së re. Në momentin kur sot po takohemi këto diskutime janë ende në zhvillim e sipër.

Që në fillim, z. President, më lejoni t'i bëj disa vrojtime për këtë proces.

I pari, vendimi për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme ka qenë i qëllimshëm. Prishja e unitetit solli fundin e koalicionit qeverisës. Mirëpo, atyre partive që kërkuan një fitore më të madhe nuk u janë realizuar pritjet.

I dyti, faza kalimtare është dëshmuar të jetë shumë sfiduese. Koalicioni kryesor nuk ka mundur të arrijë një shumicë absolute, disa parti kanë shënuar një rritje shumë të vogël, derisa partitë me përvojë të gjatë opozitare kanë shënuar rritje të konsiderueshme. Si rrjedhojë, tani kemi një ndryshim në mjedisin politik të Kosovës, i cili është nga më të mëdhenjtë në shumë vite. Një faktor që mund t'i ketë kontribuar këtij ndryshimi është vala e ndryshimeve në mendjen e shumë votuesve, posaçërisht të brezit të ri, për të cilët punësimi, qasja në arsim dhe në mundësi ekonomike, zvogëlimi i korrupsionit dhe fuqizimi i sundimit të ligjit ishin shqetësimet kryesore. Retorika etnonacionaliste u duk të jetë më pak e

efektshme për bashkimin e shumicës së elektoratit sesa që ka qenë rasti në të kaluarën. Mjedisi i ri politik pas zgjedhjeve duket se po ndikon tek pozicionimi i të gjitha partive për zgjedhjet komunale që do të mbahen në tetor.

I treti, nuk ka dyshim se zgjedhjet në përgjithësi kanë qenë të lira, të drejta dhe konkurruese përkundër periudhës shumë të shkurtër për përgatitje dhe për fushatë. Misioni zyrtar vëzhgues i Bashkimit Evropian e theksoi këtë, duke përmendur njëkohësisht problemet e kamotshme të përditësimit të listave të votuesve dhe të sigurimit të të drejtës së votimit për votuesit jashtë Kosovës. Ne vlerësojmë kontributin e rëndësishëm të ekipit vëzhgues të BE-së dhe të vëzhguesve të tjerë gjatë zgjedhjeve, si dhe gjithashtu dëshirojmë të theksojmë rolin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë lidhur me lehtësimin e votimit në komunat e veriut dhe me ofrimin e ndihmesës teknike Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Është me rëndësi të ceket se nuk ka pasur kundërshtim domethënës të rezultateve.

Përqindja e përgjithshme e daljes në zgjedhje ishte 41%. Derisa kjo përqindje nuk ndryshon shumë nga zgjedhjet e vitit 2014, ka qenë e dukshme se shumë votues të ri kanë marrë pjesë me dallime të dukshme prej vendit në vend, duke filluar nga nën 30% në disa komuna e deri te mbi 60% në disa të tjera. Në zonat me popullatë serbe, dalja në zgjedhje ka qenë më e larta e regjistruar kohëve të fundit. Duhet ta kemi parasysh se serbët e Kosovës kanë evoluuar nga pozita e bojkotit të zgjedhjeve të Kosovës, në pjesëmarrje të pjesshme, duke arritur tani deri te pjesëmarrja aktive.

Këto zgjedhje nuk krijuan momentin për ndryshime përkritazi me pjesëmarrjen e grave. Derisa entitetet politike respektuan kuotën gjinore në bazë të Ligjit për zgjedhje, përfaqësimi i grave në pozitat udhëheqëse mbetet i kufizuar. Nuk ka

kandidate femra për kryeministre, dhe pak femra janë përmendur për kabinetin e ardhshëm. Pjesëmarrja e grave në organet zgjedhore ka mbetur gjithashtu e ulët, me vetëm 9% të anëtareve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

I katërti, ndoshta shqetësimi më i madh është se vet procesi i zgjedhjeve ka konsumuar energjinë e institucioneve gjatë tre muajve të kaluar. Në fakt, vakumi i institucioneve funksionale ka penguar përparimin rreth një vistri të gjerë të prioritetëve të qeverisë. Mundësitë e mëdha ekonomike dhe shoqërore nuk janë shfrytëzuar gjatë kësaj periudhe, për shembull, nga resurset që vazhdojnë të jenë në dispozicion përmes Mekanizmit për Stabilizim dhe Asocim të Evropës. Në fund të korrikut, Fondi Monetar Ndërkombëtar anuloi këstin e parë të programit të tij dyvjeçar të financimit në mungesë të qeverisë me autorizime të plota për realizmin e rishkimit të tij. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, investimet e huaja gjatë këtij viti kanë rënë për afro një të tretat. Klima e pasigurisë politike gjatë tremujorit të fundit është gjithsesi e lidhur me këto fakte.

Z. President,

Dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen tek një zhvillim tjetër i rëndësishëm në regjion, gjegjësisht tek nisma e kryetarit Vuçiq të Serbisë për një dialog të brendshëm rreth Kosovës, çështje kjo për të cilën pata mundësi të diskutoj me të dhe me zëvendëskryeministrin e parë dhe ministrin e Jashtëm, Daçiq, javën e kaluar në Beograd. Më 24 korrik, kryetari Vuçiq publikisht u deklarua se në mënyrë që përparimi i Serbisë të jetë i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm, serbët duhet të përpiqen që ta zgjidhin çështjen e Kosovës dhe që mos "t'ia lejnë barrën më të madhe" brezit të ardhshëm. Ai gjithashtu paralajmëroi se nëse konflikti historik mes serbëve dhe shqiptarëve nuk zgjidhet, do të ishte dështim i përbashkët i të

dyja palëve dhe se përpjekja kërkon “një proces të gjatë, të ndërlikuar dhe shpesh të dhimbshëm”.

Ministri i Jashtëm i Kosovës, Hoxhaj, mirëpriti deklaratën, ndërsa kryeministri i Shqipërisë, Rama, gjithashtu shprehu respektin e tij për këtë nismë, duke përsëritur se zgjidhja afatgjatë për Kosovën do të ishte “në interes të të gjithëve”.

Siç na mëson edhe historia, kërrimi i një kompromisi të drejtë, të vështirë dhe shpesh të dhimbshëm kërkon lidërsip të fortë. Duhet të jetë e qartë se një lidërsip i tillë kërkohet nga të gjithë, nëse dëshirojmë të arrijmë paqe afatgjatë në interes të të gjithë atyre që jetojnë në regjionin e Ballkanit perëndimor. Këtu e theksoj fjalën regjion, pasi që paqja dhe stabiliteti në Kosovë janë ngushtë të ndërlidhura me paqen dhe stabilitetin në regjion dhe me normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit. Siç e dimë të gjithë, problemet janë të natyrës regjionale, andaj edhe zgjidhjet duhet të jenë të kësaj natyre.

Z. President,

Siç është theksuar në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, progresi në dialogun e lehtësuar nga BE-ja është ngadalësuar nga proceset politike, qoftë në Beograd apo në Prishtinë, por edhe nga implementimi i pjesshëm i marrëveshjeve të cilat janë arritur para katër e më shumë viteve. Më 3 korrik, Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian Mogherini ishte nikoqire e një takimi në mes të Presidentit të Serbisë dhe të Kosovës, me synimin për të lëvizur këtë proces përpara. Nëse negociatat e rëndësishme për interesat afatgjate do të mbësni në rend të ditës, duhet pritur që, me qartësimin e situatës politike në Prishtinë, dialogu mund të fillojë sa më shpejtë që të jetë e mundur - jo thjeshtë për të implementuar

marrëveshjet kryesore të arritura deri tani, por edhe për avancimin e negociatave në dobi të të dyja palëve.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, u mbajt edhe Samiti 2017 për Ballkanin perëndimor në Trieshtë, Itali. Ishte samiti i katërt vjetor në kuadër të Procesit të Berlinit, i hartuar të shtyjë përpara integrimin evropian për të gjitha shtetet e Ballkanit perëndimor. Ky proces fuqizon karakterin natyrshëm rajonal të çështjeve që më së shumti ndikojnë drejtpërdrejt në të ardhmen e Kosovës. Mundësitë për krijimin e një tregu të përbashkët, zgjerimi i infrastrukturës, trajtimi më i mirë i problemeve dhe sfidave mbarërajonale ishin të gjitha në rendin e ditës.

Z. President,

Pajtimi politik, vetvetiu, nuk mund t'i tejkalojë të gjitha ndarjet. Duhet të bashkërendohet me pajtimin shoqëror, me ndërtimin e besimit dhe me bashkëpunimin në të gjitha nivelet. Puna në ofrimin e ndihmës për të inkurajuar besim më të madh në mes të komuniteteve është njëri prej prioritetëve kryesore të UNMIK-ut - ne vazhdimisht shqyrtojmë se si Misioni mund të kontribuojë më së miri, në kuadër të mandatit tonë ekzistues, në drejtim të përmirësimit të marrëdhënieve në mes të komuniteteve. Ne këtë e bëjmë së bashku me partnerët qeveritarë, joqeveritarë dhe me ata ndërkombëtarë.

Qartazi, ndërtimi i besimit nuk është një ngjarje, por një proces afatgjatë i transformimit të mosbesimit në bashkëjetesë, dhe përfundimisht në bashkëpunim të vërtetë. Kudo që ne kemi mundësi, jemi të përqendruar në promovimin e aktiviteteve të reja bashkëpunuese në mes të liderëve komunalë dhe atyre të komuniteteve dhe institucioneve, duke përkrahur punën e akterëve

të zellshëm lokalë. Dëshiroj të theksoj disa nga iniciativat tona të fundit për avancimin e ndërtimit të besimit në mes të komuniteteve.

Në fund të qershorit, unë isha bashkëprezantues me Komisionerin e Lartë për të Drejtat e Njeriut Zeid Ra'ad Al Hussein, në një tryezë të rrumbullakët ndërkombëtare në Gjenevë, për të kthyer vëmendjen tek rastet e shumta të pazgjidhura të personave të zhdukur nga konflikti i Kosovës. Kjo vazhdon të jetë një pengesë e madhe për pajtimin shoqëror. Në kuadër të kësaj fushe ne kemi arritur të fuqizojmë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve të familjeve të personave të zhdukur, dhe të kërkojmë përkushtim më të madh nga delegacioni i Prishtinës dhe i Beogradit, si dhe përkrahje të fuqishme nga bashkësia ndërkombëtare, veçanërisht nga KB-ja, për të përcaktuar fatin e 1,658 personave të cilët ende raportohen të pagjetur.

Gjithashtu në qershor, misioni ynë ishte nikoqir i Asamblesë së parë rinore të KB-së në Kosovë, ku morën pjesë më shumë se 140 liderë të rinj – 60% e tyre gra – duke përfaqësuar të gjitha komunitetet etnike të Kosovës. Kjo ngjarje ishte rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me UNICEF-in, me UNDP-në, me OSBE-në, me BE-në dhe me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës. Kjo Asamble demonstroi energjinë e shoqërisë civile të Kosovës dhe paraqiti një pasqyrë publike të spikatur të progresit që mund të arrihet. Bazuar në Rezolutën 2250 të Këshillit të Sigurimit, pjesëmarrësit e krijuan një udhërrëfyes për rininë, për paqen dhe për sigurinë në Kosovë, që gjithashtu trajtoi fuqizimin e grave të reja, për t'i shërbyer strategjisë më të gjerë që është duke u hartuar nga autoritetet e Kosovës.

UNMIK-u vazhdon të jetë aktiv në angazhimet e tij me qeveritë lokale, në mesin e të cilave mund të them se bëhen përpjekje të mëdha për të trajtuar

çështjet me rëndësi për elektoratin e tyre. Në fund të korrikut, ne ndihmuam mbajtjen e një takimi në mes të dhjetë liderëve komunalë në pjesën juglindore të Kosovës, të drejtuar nga kryetari i komunës më të madhe të atij rajoni. Në këtë takim u debatua për shumë çështje praktike, duke përfshirë edhe bashkëpunimin ekonomik, dhe ekspozimin specifik të atij rajoni ndaj radikalizmit dhe rreziqeve nga ideologjitë ekstremiste. Gjatë muajve të ardhshëm ne do të ndërmarrim iniciativa të ngjashme në rajone të tjera të Kosovës. Përpjekjet tona për fuqizimin e ndërtimit të besimit ndërmjet komuniteteve janë të drejtuara në nivele shumë praktike, jo vetëm në ndërtimin e kornizave ekzistuese, por edhe në angazhimin tonë për krijimin e kornizave të reja, duke u bazuar në problemet e veçanta të komuniteteve lokale.

Z. President,

Kosova ka vazhduar të ndërmarrë hapa për të demonstruar zotimet e saja për drejtësi dhe për sundim të ligjit në sferën ndërkombëtare. Pas një sërë hapash ligjorë përfundimtarë, duke përfshirë miratimin e rregullores së punës, më 5 korrik, Dhomat e Specializuara, një mekanizëm për trajtimin e disa kapitujve më të vështirë dhe më të dhimbshëm të pasluftës, u bë funksional në Hagë. Tani janë të gatshme të pranojnë dosje dhe aktakuza, me bashkëpunim të plotë me të gjitha institucionet relevante të Kosovës.

Z. President,

Pas tre muajsh nga fushata elektorale dhe paqartësia pas zgjedhjeve, për Kosovën është me rëndësi të lëvizë përpara në mënyrë serioze dhe të përgjegjshme, dhe për bashkësinë ndërkombëtare të punojë së bashku që të

vazhdojë ofrimin e përkrahjes thelbësore. Në këtë frymë, ne do të vazhdojmë të angazhohemi me të gjithë partnerët tanë në drejtim të objektivit tonë të përbashkët të promovimit të paqes dhe stabilitetit.

Unë falënderoj të gjithë anëtarët e Këshillit për vëmendjen e tyre dhe për mbështetjen e vazhdueshme.

Ju faleminderit.